



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2356 Prot.

Tiranë, më 15 / 05 /2020

URDHËR

Nr. 326, datë 15 . 05 .2020

PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 7, pika 4 gërma b të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Stërviçet e sportistëve lejohen të zhvillohen, për të gjithë llojet e sporteve, vetëm në ambiente të hapura.
2. Aktivitetet sportive dhe stërviçet e sportistëve në ambiente të mbyllura vijojnë të jenë të ndaluara.
3. Aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri të kryhen duke respektuar protokollat e sigurisë të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.
4. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhëri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.
5. Çdo parashikim i mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

